

UDHËZIM
Nr.2, datë 25.2.2009

PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT TË ZONËS TË
ADMINISTRIT ZGJEDHOR

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbështetje të nenit 21 pika 1, nenit 23 pika 1, germa “b”, nenit 28, 29 e vijues të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, si dhe vendimit të KQZ-së nr.4, datë 16.02.2009 “Për caktimin e partive politike që kanë të drejtë të paraqesin propozime për anëtarë të KZAZ-ve për zgjedhjet për Kuvend të datës 28 qershor 2009,

UDHËZON:

PJESA I
TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Ky udhëzim ka për qëllim të rregullojë mënyrën e organizimit dhe funksionimit të KZAZ- së, të drejtat dhe detyrimet e saj dhe të anëtarëve, caktimin e rregullave për thirrjen dhe zhvillimin e mbledhjeve, marrjen e vendimeve, si dhe marrëdhëniet e KZAZ-së me të tretët.

Neni 2
Parime të përgjithshme

1. Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor është organ kolegjal. Ai përgjigjet për administrimin dhe zhvillimin e zgjedhjeve në Zonën e Administrimit Zgjedhor përkatës. Të drejtat dhe detyrat e KZAZ-së përcaktohen në Kodin Zgjedhor dhe në aktet nënligjore të KQZ-së.

2. KZAZ-ja ushtron veprimtarinë e vet në përputhje me ligjin, në mënyrë të paanshme, profesionale dhe transparente.

PJESA E II
PËRBËRJA E KZAZ-SË

Neni 3
Ngritja e KZAZ-së

1. KZAZ-ja përbëhet nga shtatë anëtarë dhe sekretari, të cilët emërohen sipas procedurës së parashikuar në nenin 29, pika 1, gjerat “a”, “b” dhe “c”, të Kodit Zgjedhor.

2. Anëtarët e KZAZ-së për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë 2009, propozohen nga partitë politike si më poshtë:

- a) Dy anëtarë të propozuar nga Partia Demokratike e Shqipërisë;
- b) Dy anëtarë të propozuar nga Partia Socialiste e Shqipërisë;
- c) Një anëtar i propozuar nga Partia Republikane Shqiptare;
- d) Një anëtar i propozuar nga Partia Socialdemokrate e Shqipërisë;
- e) Në përputhje me vendimin nr.7, datë 18.2.2009 të KQZ-së “Për shpalljen e rezultatit të shortit për caktimin e partisë që do të propozojë anëtarin e shtatë”, në KZAZ-të me numër tek, anëtar i shtatë propozohet nga Partia Socialiste e Shqipërisë, ndërsa në KZAZ-të me numër çift anëtar i shtatë propozohet nga Partia Demokratike e Shqipërisë.

3. Sekretari i KZAZ-së propozohet nga partia politike, e cila ka të drejtë të paraqesë propozimin për zv.kryetarin e KZAZ-së.

Neni 4

Paraqitja e propozimeve nga partitë politike

1. KQZ u dërgon njoftim partive politike, që kanë të drejtë të paraqesin propozime për anëtarë të KZAZ-së.
2. Propozimi përmban emrin, atësinë, mbiemrin dhe vendbanimin e personit që propozohet për t'u emëruar si anëtar i KZAZ-së.
3. Së bashku me të dhënat e mësipërme, propozimi shoqërohet me dokumentacionin e mëposhtëm:
 - a) Certifikatë lindje me fotografi;
 - b) Diplomë e arsimit të lartë.
4. Propozimi nga partia politike përkatëse për emërimin e sekretarit të KZAZ-së përveç të dhënave të përcaktuara në pikën 2 dhe 3, germa "a", të nenit 4 të këtij udhëzimi, duhet të shoqërohet me diplomën e arsimit juridik.

Neni 5

Emërimi i anëtarëve dhe sekretarit të KZAZ-së

1. KQZ-ja emëron me vendim anëtarët dhe sekretarin e KZAZ-së, sipas propozimeve të sjella nga partitë politike.
2. Për emërimin e anëtarëve dhe të sekretarit të KZAZ-ve, KQZ-ja mban parasysh të dhënat, që lidhen me ushtrimin e funksionit nga ana e tyre, ku përfshihen edhe trajnimet që ata kryejnë, si dhe masat disiplinore të marra ndaj tyre.

Neni 6

Shkarkimi i anëtarëve dhe i sekretarit të KZAZ-së

1. Anëtari dhe sekretari i KZAZ-së shkarkohen nga detyra sipas përcaktimeve të nenit 32, pika 1 dhe pika 3, të Kodit Zgjedhor.
2. Shkarkimi bëhet me vendim të KQZ-së.
3. Propozimi për shkarkimin e anëtarit apo sekretarit të KZAZ-së bëhet direkt në KQZ, nga çdo subjekt zgjedhor.
4. KQZ merr vendim për shkarkim, kur votojnë pro shumica e anëtarëve të KQZ-së.

Neni 7

Anëtari dhe sekretari i KZAZ-së, i shkarkuar me vendim të KQZ-së, nuk mund të rizgjidhet në këtë detyrë.

Neni 8

Lirimi nga detyra i anëtarit apo sekretarit të KZAZ-së

1. Anëtari ose sekretari i KZAZ-së lirohet nga detyra në rastet e parashikuara në nenin 32 pika 2 të Kodit Zgjedhor.
2. Kur partia politike që ka propozuar anëtarin ose sekretarin e KZAZ-së kërkon zëvendësimin e tij, ai lirohet nga detyra dhe kërkesa pranohet në çdo rast.
3. Kërkesa për lirimin e anëtarit apo sekretarit të KZAZ-së duhet të shoqërohet edhe me propozimin për zëvendësimin e tij me anëtarin ose sekretarin e ri.

Neni 9

Plotësimi i vendit vakant

1. Kur vendi i një anëtarit të KZAZ-së mbetet vakant, KQZ-ja i kërkon partisë politike përkatëse të paraqesë propozimin për anëtarin e ri. Emërimi i anëtarit të ri bëhet sipas afateve të përcaktuara në nenin 29, pika 7 dhe 8, të Kodit Zgjedhor.

2. Kur anëtari i KZAZ-së jep dorëheqjen, deklarata e dorëheqjes depozitohet në KZAZ. Sekretari bën shënimet përkatëse në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KZAZ-së dhe menjëherë i dërgon njoftimin KQZ-së lidhur me krijimin e vakancës. Sekretari i bashkëngjijt detyrimisht njoftimit një kopje të deklaratës së dorëheqjes.

3. Anëtari i KZAZ-së i dorëhequr, nuk mund të largohet nga KZAZ-ja, pa dorëzuar detyrën tek zëvendësuesi i tij.

PJESA III EMËRIMI I KRYETARIT DHE ZV.KRYETARIT TË KZAZ

Neni 10

Propozimi i Kryetarit dhe Zv.Kryetarit të KZAZ-së

1. KZAZ-ja merr vendim për propozimin e Kryetarit dhe zv.kryetarit të KZAZ-së.
2. Njëri nga anëtarët e KZAZ-së, përfaqësuesi i partisë që ka tre anëtarë në Komision, ka të drejtë të propozojë kandidaturën për kryetar të KZAZ-së.
3. Njëri nga anëtarët e KZAZ-së, përfaqësuesi i partisë që ka dy anëtarë në Komision, ka të drejtë të propozojë kandidaturën për zëvendëskryetar të KZAZ-së.
4. Të gjithë anëtarët e KZAZ-së janë detyruar të votojnë pro propozimit për emërimin e kryetarit dhe zëvendëskryetarit.
5. Vendimet e marra nga KZAZ-ja sa më sipër i dërgohen menjëherë KQZ-së.

PJESA E IV TË DREJTAT DHE DETYRAT E ANËTARIT TË KZAZ

Neni 11

Të drejtat e anëtarit të KZAZ-së

1. Anëtari i KZAZ-së ka të drejtën e shpërblimit për punën e bërë. Masa e shpërblimit përcaktohet me vendim të KQZ-së.
2. Gjatë kohës që anëtari i KZAZ-së ushtron këtë detyrë, nuk humbet të drejtat dhe detyrat në vendin e tij të punës.
3. Në rastet kur anëtari i KZAZ-së ndalohet ose arrestohet gjatë periudhës zgjedhore, organi kompetent dhe vetë KZAZ-ja njofton menjëherë KQZ-në.
4. Çdo anëtar i KZAZ-së ka të drejtë të komunikojë dhe informojë KQZ-në për çdo problem që ai e sheh të arsyeshëm.

Neni 12

Detyrat e anëtarit të KZAZ-së

1. Anëtari i KZAZ-së është i detyruar të zbatojë Kodin Zgjedhor, vendimet dhe udhëzimet e KQZ-së, aktet apo dokumentet shkresore të nxjerra nga KQZ-ja dhe të përcjella me rrugë elektronike nëpërmjet inspektorit rajonal ose drejtëpërdrejt nga KQZ-ja, si dhe vendimet e KZAZ-së.
2. Anëtari i KZAZ-së është i detyruar të paraqitet rregullisht në detyrë, në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë Udhëzim dhe akte të tjera të KQZ-së.
3. Në ushtrimin e funksionit të tij, anëtari i KZAZ-së duhet të respektojë rregullat e etikës.

PJESA V TË DREJTAT DHE DETYRAT E SEKRETARIT TË KZAZ

Neni 13

1. Sekretari i KZAZ-së ka këto të drejta:
 - a) Sekretari i KZAZ-së ka të drejtën e shpërblimit për punën e bërë. Masa e shpërblimit përcaktohet me vendim të KQZ-së;
 - b) Gjatë kohës që sekretari i KZAZ-së ushtron këtë detyrë, nuk humbet të drejtat dhe detyrat

në vendin e tij të punës;

c) Në rastet kur sekretari i KZAZ-së ndalohet ose arrestohet gjatë periudhës zgjedhore, organi kompetent dhe vetë KZAZ-ja, njofton menjëherë KQZ-në;

ç) merr pjesë në mbledhjet e KZAZ-së si anëtar pa të drejtë vote;

d) diskuton dhe jep mendimin e tij në mbledhjet e KZAZ-së, për çështje që shqyrtohen.

2. Sekretari i KZAZ-së, përveç detyrave të parashikuara në nenin 34 të Kodit Zgjedhor, kryen edhe këto detyra:

a) administron dhe ruan të gjithë dokumentacionin e KZAZ-së, si dhe është përgjegjës për përdorimin e vulës;

b) Sekretari i KZAZ-së është i detyruar të vulosë çdo vendim të KZAZ-së që ka kuorumin e nevojshëm të votave dhe është firmosuar rregullisht nga anëtarët;

c) jep asistencë juridike për KZAZ-në;

ç) mban Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KZAZ-së ku shënon të gjithë veprimtarinë që kryen KZAZ-ja. Në fillim të çdo mbledhjeje evidenton prezencën e anëtarëve të KZAZ-së;

d) regjistron në Regjistrin e Korespondencës së KZAZ-së të gjitha aktet që hyjnë në KZAZ dhe dalin prej saj;

dh) regjistron të gjitha vendimet që merr KZAZ-ja në Regjistrin e Vendimeve;

e) menjëherë pas miratimit të vendimit të marrë nga KZAZ-ja, sekretari përpilon aktin zyrtar në përputhje me modelet e miratuara nga KQZ-ja;

ë) Regjistron në Procesverbalin e Konstatimit shkeljet e konstatuara gjatë procesit të marrjes në dorëzim të materialeve të votimit pas mbylljes së votimit nga KQV-ja në KZAZ, si dhe shkeljet e konstatuara gjatë procesit të numërimit të votave në vendin e numërimit të votave.

f) kryen detyra të tjera që burojnë nga Kodi Zgjedhor dhe akte nënligjore të KQZ-së.

PJESA VI

DETYRAT DHE FUNKSIONIMI I KZAZ-SË

Neni 14

Detyrat e KZAZ-së

Përveç detyrave të përcaktuara në nenin 33 të Kodit Zgjedhor, KZAZ-ja ushtron edhe këto kompetenca:

1. Njofton anëtarët KQV-ve për programet e trajnimit të organizuar nga KQZ-ja, merr masa për mbarëvajtjen e tyre, si dhe evidenton pjesëmarrjen;

2. Mban kontakte të vazhdueshme me organet e qeverisjes vendore dhe dërgon informacion në mënyrë periodike në KQZ dhe ZRZ;

3. Bashkëpunon me organet e qeverisjes vendore, për sigurimin e ambienteve dhe bazës së nevojshme logjistike, për funksionimin e KZAZ-së dhe KQV-ve;

4. Afishon në vende publike të dhëna që lidhen me zhvillimin e zgjedhjeve në zonën zgjedhore;

5. Shqyrton dhe merr vendim për të gjitha kërkesat dhe ankesat e paraqitura nga subjektet zgjedhore;

6. Mbikëqyr dhe asiston përgatitjen e mjediseve të qendrave të votimit, merr masa për përshtatjen e mjediseve të QV-ve, për të lehtësuar votimin e personave me aftësi të kufizuara;

7. Verifikon dhe mbikëqyr masat, që janë marrë për sigurimin dhe ruajtjen e materialeve zgjedhore në KZAZ dhe KQV deri në përfundim të procesit të votimit.

Neni 15

Zyra e KZAZ-së

1. Vendndodhja e zyrave të KZAZ-së duhet të plotësojë kushtet e parashikuara në nenet 93 e 94 të Kodit Zgjedhor:

2. Në zyrën e KZAZ-së, në një vend të dukshëm, duhet të vendoset flamuri kombëtar.

3. Në hyrjen kryesore, për në zyrën e KZAZ-së, duhet të vendoset tabela treguese e KZAZ-së, si dhe të jenë afishuar emrat e anëtarëve të KZAZ-së, numri i telefonit të zyrës dhe orari i punës.

4. Zyra e KZAZ-së është e pajisur me linjë telefonike të rrjetit fiks.

Neni 16

Dokumenti i identifikimit

1. Gjatë ushtrimit të detyrës anëtarët dhe sekretari i KZAZ-së, janë të detyruar të mbajnë në mënyrë të dukshme dokumentet e identifikimit sipas modelit të miratuar nga KQZ.

2. Vëzhguesit vendas dhe të huaj janë të detyruar që gjatë qëndrimit në mjediset e KZAZ-së, të mbajnë dokumentin përkatës të identifikimit.

Neni 17

Vula e KZAZ-së dhe përdorimi

1. KZAZ-ja përdor vulën e dërguar nga KQZ-ja.

2. Vula e KZAZ-së mbahet nga Sekretari, i cili e administron atë në përputhje me Kodin Zgjedhor dhe aktet e tjera të KQZ-së.

3. Vula e KZAZ-së vendoset në të gjitha aktet e nxjerra dhe të miratuara nga KZAZ-ja.

4. Vula nuk mund të nxirret për asnjë arsye jashtë ambienteve të punës së KZAZ-së.

5. Në rast se vula e KZAZ-së bëhet e papërdorshme, KZAZ-ja mban një procesverbal në Librin e Protokollit në të cilin pasqyron rrethanat e pamundësisë së përdorimit të vulës dhe ia bën këtë me dije KQZ-së. KQZ-ja vlerëson informacionin e paraqitur dhe realizon procedurat e nevojshme për pajisjen e KZAZ-së me vulën e re.

6. Në rast se vula e KZAZ-së humbet, KZAZ-ja pasqyron faktin në Librin e Protokollit, si dhe lajmëron organet e policisë. KZAZ-ja i dërgon KQZ-së kopje të procesverbalit të mbajtur dhe njoftimit për organet e policisë.

Neni 18

Koha e punës së KZAZ-së

1. Gjatë periudhës zgjedhore dhe deri tre ditë para datës së zgjedhjeve, KZAZ-ja punon paradite nga ora 08.00 – 13.00 dhe mbasdite 16.00 - 20.00.

2. Tre ditë para datës së zgjedhjeve deri në shpalljen e rezultatit përfundimtar dhe dorëzimin në KQZ të dokumentacionit zgjedhor përkatës, KZAZ-ja qëndron në mënyrë permanente e mbledhur në zyrë. Ndërprerja dhe rifillimi i punës në çdo rast bëhet me vendim të KZAZ-së.

3. Sekretari i KZAZ-së shënon në procesverbal kohën e ndërprerjes dhe rifillimit të punës.

PJESA VII

MBLEDHJET E KZAZ

Neni 19

Njoftimi për mbledhjen e parë të KZAZ-së

1. Mbledhja e parë e KZAZ-së thirret me vendim të KQZ-së.

2. Vendimi për mbledhjen e KZAZ-së bëhet publik.

3. Vendimi u dërgohet partive politike, të cilat kanë propozuar anëtarët e KZAZ-së dhe përmban: datën, vendin dhe orën e mbledhjes të KZAZ-së.

4. Në përputhje me vendimin e KQZ-së, Inspektori Rajonal merr masa për njoftimin e anëtarëve dhe përgatitjen e mbledhjes së KZAZ-së.

5. Mbledhja e parë e KZAZ-së drejtohet nga anëtari më i vjetër në moshë.

6. Në këtë mbledhje, KZAZ-ja merr Vendim për propozimin e Kryetarit dhe Zv.kryetarit të KZAZ-së, sipas modeleve të miratuara nga KQZ-ja.

Procedura e zhvillimit të mbledhjeve të KZAZ-së

Neni 20

1. Mbledhjet e KZAZ-së janë publike. Ato zhvillohen vetëm në ambientet e saj të punës.
2. Mbledhjet e KZAZ-së janë të vlefshme kur në to marrin pjesë me shumë se gjysma e anëtarëve të KZAZ-së.
3. Mbledhjet e KZAZ-së në vijimësi thirren nga Kryetari, zv.kryetari ose së paku nga dy anëtarë të saj. Sekretari është përgjegjës për njoftimin e anëtarëve.
4. Sekretari është përgjegjës për përgatitjen e materialeve të mbledhjes.

Neni 21

1. Mbledhja e KZAZ-së drejtohet nga kryetari dhe në mungesë të tij nga zëvendëskryetari.
2. Drejtuesi i mbledhjes paraqet çështjen që është për shqyrtim dhe i jep fjalën anëtarëve për të diskutuar.
3. Çdo anëtar i KZAZ-së diskuton dhe paraqet propozime për çështje që janë në rendin e ditës.
4. Pasqyrimi i mbledhjeve të KZAZ-së, bëhet në Librin e Protokollit të Mbledhjeve, i cili duhet të përmbajë të paktën:
 - a) Datën, vendin dhe orën e mbledhjes;
 - b) Anëtarët që morën pjesë;
 - c) Çështjet që u diskutuan;
 - d) Përmbajtjen e diskutimeve;
 - e) Rezultati i votimit të anëtarëve të KZAZ-së;
 - f) Vendimet që u morën.
5. Në mbledhjen e KZAZ-së pjesëmarrësve u ndalohet çdo lloj komunikimi me telefon ose forma të tjera me të tretët.
6. Në përfundim të mbledhjes procesverbali përkatës në Librin e Protokollit të Mbledhjeve firmoset në çdo faqe nga sekretari. Anëtarët e KZAZ-së, në se dëshirojnë, kanë të drejtë të nënshkruajnë procesverbalin si më sipër.

PJESA VIII VENDIMARRJA

Neni 22

Mbyllja e diskutimeve dhe votimi i propozimeve

1. Në përfundim të diskutimeve, drejtuesi i mbledhjes paraqet me radhë propozimet dhe fton anëtarët e KZAZ-së për të votuar për secilin propozim.

Neni 23

Procedura e votimit dhe firmosja e vendimeve

1. Vendimet në KZAZ merren me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të KZAZ-së. Sekretari nuk ka të drejtë vote.
2. Vendimet e KZAZ-së nënshkruhen nga të gjithë anëtarët që kanë marrë pjesë në votim, si dhe vulosen me vulën e KZAZ - së nga sekretari.
3. Secili prej anëtarëve të KZAZ-së krahas nënshkrimit të tij në vendim, shënon votën “pro” ose “kundër”.
4. Vendimet e KZAZ-së shoqërohen me mendimin e pakicës nëse ka të tillë.
5. Sekretari i KZAZ-së shënon në Librin e Protokollit të Mbledhjeve rezultatet e votimit për çdo propozim.
6. KZAZ-ja është e detyruar që të bëjë menjëherë publike, vendimet e marra dhe të dërgojë në

KQZ një kopje të këtyre vendimeve.

PJESA IX
DOKUMENTACIONI I KZAZ-SË

Neni 24

1. Sekretari i KZAZ-së është përgjegjës për mbajtjen në arkiv dhe sistemimin e dokumentacionit zgjedhor të KZAZ-së. Sekretari i KZAZ-së, krijon dosje të veçanta në lidhje me vendimet dhe udhëzimet e dërguara nga KQZ-ja, në lidhje me aktet e nxjerra prej saj, me kërkesat, ankesat apo pretendimet e subjekteve zgjedhore, me emërimin e anëtarëve të KQV-ve, caktimin e anëtarëve të grupeve të numërimit të votave, etj.

2. Me kërkesë të subjekteve zgjedhore, Sekretari i KZAZ-së jep kopje të akteve.

3. Libri i Protokollit të Mbledhjeve, Regjistri i Korrespondencës, Regjistri i Vendimeve dhe Procesverbali i Konstatimit të KZAZ-së mbahen dhe administrohen nga Sekretari dhe dorëzohen në përfundim të procesit zgjedhor në KQZ.

Neni 25

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Arben Ristani